

17.02.2025



Sele. Kosh. J. S. 17.02.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 1321 prot.

Gjirokastrë, më 14.02.2025

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara tek prefekti i qarkut.

KËSHILLIT TË BASHKISË TEPELENË

Tepelenë

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e qarkut”, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendimi i këshillit të bashkisë Nr. 3, datë 30.1.2025 “Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor”, konfirmohet.
2. Vendimi i këshillit të bashkisë Nr. 4, datë 30.1.2025 “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë”, në parim konfirmohet, në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse.
3. Vendimi i këshillit të bashkisë Nr. 6, datë 30.1.2025 “Për miratimin e listës emërore të familjeve përfituese, si dhe vlerën e bashkëfinancimit me qëllim përfitimin e fondeve nga programi i strehimit ‘Përmirësimi i banesave ekzistuese për vitin 2025’”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e qarkut”, i ndryshuar, Prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e Prefektit të qarkut.
4. Vendimi i këshillit të bashkisë Nr. 10, datë 30.1.2025 “Për miratimin e planit operacional për vitin 2025 në fondin pyjor dhe kullësor të Bashkisë Tepelenë”, konfirmohet.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Odise Kote

Adresa: Sheshi “Çerçiz Topulli”, Gjirokastrë, Shqipëri, Tel ++35584263435 Fax ++355263434 Email Prefekti.Gjirokastrë@mbr.gov.al

